

PROCESVERBAL

nga vazhdimi i parë i seancës së 11-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale mbajtur më 25.3.2026

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski dhe Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: mr. Gordana Majnova (udhëtim zyrtar).

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të punësuar nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, dr. Ivana Stojanovska, mr. Ivona Mufisheva, Goran Radunović, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska-Jotevska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi vazhdimin e parë të seancës së 11-të të Këshillit. Seanca filloi në orën 14:30 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Në lidhje me vazhdimin e seancës së 11-të kryetari i Këshillit propozoi plotësim të Rendit të ditës me pikë të re, të shënuar si pika 9, nën titullin: "Propozim- vendim për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Gurra ShPKNJ Kërçovë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi propozimin për plotësimin e rendit të ditës për seancën e 11-të.

RENDI I DITËS

(vazhdimi i seancës së 11-të)

9. Propozim - vendim për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA ShPKNJ Kërçovë.

Pika 9

Drejtori i Agjencisë, dr. Zoran Trajčevski, shpjegoi propozim-Vendimin për anulimin e Vendimit për heqjen e lejes të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV GURRA ShPKNJ Kërçovë. Ai shpjegoi se në seancën e rregullt të 11-të, Këshilli, duke vepruar në përputhje me ligjin, miratoi Vendim për heqjen e lejes të TV Gurra ShPKNJ Kërçovë, për shkak të mospagesës së kompensimit vjetor për transmetim televiziv në afatin e përcaktuar ligjor. Plotësuesei sqaroi se, duke marrë parasysh se Vendimi për heqjen e lejes ende nuk është

publikuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", si dhe faktin se gjatë ditës së sotme transmetuesi e ka paguar plotësisht borxhin, propozohet që Këshilli i Agjencisë të miratojë Vendim për anulimin e Vendimit të miratuar më parë për heqjen e lejes. Drejtori informoi se në ditën e miratimit të Vendimit për heqjen e lejes, përkatësisht më 23 mars 2026, pronari i transmetuesit ka kryer pagesën e shumës për kompensim nga llogari transaksioni private. Në këtë drejtim, ai theksoi se Agjencia e ktheu pagesën, duke marrë parasysh se në përputhje me dispozitat ligjore, nuk lejohet një person fizik të bëjë një pagesë në emër të një transmetuesi.

Këshilltarja mr. Zirjeta Jajaga, shprehu mirënjohje të veçantë për shërbimin profesional të Agjencisë, duke theksuar angazhimin e tyre të vazhdueshëm dhe qasjen profesionale. Ajo theksoi se shërbimi gjatë gjithë procesit mbajti komunikim me transmetuesin, me qëllim ofrimin e mbështetjes së duhur për kapërcimin e situatës dhe përbushjen në kohë të detyrimeve.

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, u pajtua me deklaratën dhe theksoi se qëllimi kryesor i Agjencisë dhe i Këshillit është të mundësojë funksionimin papengësë të mediave dhe të krijojë kushte për funksionimin e tyre të ligjshëm dhe të vazhdueshëm.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin anulohet plotësisht Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr. 08-66 datë 24.3.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Gurra ShPKNjP Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023, për shkak se transmetuesi e ka përbushur plotësisht detyrimin ligjor për pagesë të kompensimit vjetor të lejes për transmetim televiziv, përkatësisht ka kryer pagesë në shumë prej 118.740,00 (njëqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e dyzet) denarë, në përputhje me Faturën e dhënë nr.2026 -100-0020 datë 12.1.2026 me (nr.y në ark. 05 -106/1 datë 12.1.2026).

Vendimi me të cilin anulohet në tërësi Vendimi i Këshillit të Agjencisë PA1 nr.08-66 datë 24.3.2026 për heqjen e lejes për transmetim televiziv të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TV Gurra ShPKNjP Kërçovë, PA1 nr.08-58 datë 7.9.2023 është përfundimtar dhe hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Vendimin e lartpërmendur ta publikojë në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
mr. Sasho Stefanovski**